

AYER SVIN VE AGJUSORNE  
Bush

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, të zbatueshëm sipas Rregullores së PSSP të KB. nr. 2003/30, nenit 3 (nën b) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nenit 19, alinea 1, pika 2, dhe nenit 39, alinea 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 korrik 2006, mori këtë:

## V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban për një pjesë të lokacionit "Atmejdani" të Prizrenit .

### Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRRU-së për një pjesë të lokacionit "Atmejdani", të qytetit të Prizrenit, të hartuar dhe ofruar si donacion prej byrosë projektuese APPS "ARKOS" – nga Gjakova (bartës i hartimit të Planit Rregullues të ofruar për këtë pjesë të qytetit të Prizrenit), në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi për miratimin e PRRU do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

- Pjesa tekstuale përmban:
  - kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.
- Pjesa grafike duhet të përmbajë:
  - paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

### Neni 2

Plani Rregullues Urban për një pjesë të lokacionit "Atmejdani" të qytetit të Prizrenit përfshin këto ngastra kadastrale: nr. 11059/1; 7075/1; 7074/1; 11059/2 dhe 11059/2 gjithsej në sipërfaqe prej 1.90 ha.

Me Planin Zhvillimor Urban për këtë lokacion është i definuar: Ndërtimi për nevoja të administratës, tregtia, hoteleria dhe banimi kolektiv.

### Neni 3

Plani Rregullues Urban për një pjesë të lokacionit "Atmejdani", përfshin lokacionin që ndodhet prapa "Shtrumpfave" te stacioni hekurudhor, që kufizohet me rrugët: "Mbreti Pirro", "De Rada" dhe sheshi "Bil Klinton", në pjesën perëndimore të qytetit kufizohet me zonën industriale dhe përkufizohet me:

- Nga ana perëndimore me zonën industriale;

- nga ana veriore dhe lindore me rrugën Prizren-Gjakovë dhe nga ana jugore me pjesën e zonës së ngushtë të qytetit.

#### Neni 4

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi është i planifikuar rregullimi i hapësirës në pajtim me Planin Zhvillimor Urban që bazohet me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm me qëllim që t'ua mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim dhe kushte të sigurta të investimit.

#### Neni 5

Plani Rregullues Urban do të vlejë për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

#### Neni 6

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, al. 2 të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit.


#### Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike dhe Drejtoria për Gjeodezi e Kadastër.

#### Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**  
Asambleja Komunale  
Nr 01/011-42  
Më 27 korrik 2006  
Prizren



Kryetari i Kuvendit  
Mr. Eqrem Kryeziu